



KRU **Hidroregjioni Jugor** sh.a. Prizren

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren  
email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

---

**KRU”Hidroregjioni Jugor”Sh.A në Prizren për të ofruar shërbime sa më të mira për konsumatorët ballafaqohet me sfida të shumta të humbjeve të ujit që janë rreth 60% në nivel rajonal për shkak të kyçjeve ilegale, keqpërdorimeve dhe rrjetit të vjetruar .**

**Por me Kodin e Ri Penal të Republikës së Kosovës i cili ka hyr në fuqi nga data 01.01.2013, kyçjet ilegale dhe keqpërdorimet në rrjetin e ujësjellësit konsiderohen Vepra Penale.**

**Lidhja e pa autorizuar apo rilidhja në shërbimet e ujësjellësit në bazë të - Neni 321, -** dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

**Ndryshimi, nderhyrja dhe largimi i njëhisorit të shërbimeve të ujësjellësit – në bazë të neneve 323 dhe 324** dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

**Vjedhja e shërbimeve të ujësjellësit –në bazë të Neni 326,** dënohet me gjobë dhe me burgim deri në një (1) vit,

- Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet me forcë ose kanosje serioze, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.
- Nëse vlera e shërbimeve të vjedhura është më pak se pesëdhjetë (50) Euro, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

**Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike të ujësjellësit – në bazë të Neni 366,** dënohet me burgim deri në pesë (5) vjet;

- nëse vepra penale kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
- nëse vepra penale rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëm substancial pasuror, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
- nëse vepra penale rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
- nëse vepra penale rezulton me lëndim të rëndë trupor ose dëm substancial pasuror, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet, dhe

**Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare – në bazë të Neni 409** dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

- Kushdo që merr pjesë në një grup të personave që me veprim të përbashkët pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
- Udhëheqësi apo organizatori i grupit që kryen vepra penale nga paragrafi i këtij neni, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
- Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni përfshin kanosjen për përdorimin e armës apo mjetit të rrezikshëm ose rezulton me lëndim trupor, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

- Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet ndaj gjyqtarit, prokurorit, zyrtarit të gjykatës, zyrtarit të prokurorisë apo personit të autorizuar nga gjykata dhe prokuroria zyrtarit policor, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
- Nëse vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

**Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare – në bazë të Neni 410,** dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

- Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të lehtë trupor të personit zyrtar apo ndihmësi të tij ose përfshin kanosje për përdorimin e armës apo mjetit të rrezikshëm, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
- Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor të personit zyrtar apo ndihmësit të tij, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri **në dhjetë (10) vjet.**
- Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi 1., 2. ose 3. i këtij neni është provokuar nga veprimi i kundërligjshëm apo i vrazhdë i personit zyrtar, gjykata mund ta zbusë dënimin.

**Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave -në bazë të Neni 414,** dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

**KRU”Hidroregjioni Jugor”ka për qëllim furnizimin me ujë të gjithë konsumatorët e vet dhe jo ti denoj ata.**

**Uji është jetë mos e keqperdoni atë sepse edhe ky është akt i denueshëm.**